

SYLLABUS

Lënda: Perspektiva e re në pikturë II

Viti -II- (Semestri: III - IV)

Prof. Majlinda Kelmendi

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arteve Programi i studimit - Artet Vizuale (BA) – Art Konceptual dhe Mediat e reja, Ilustrim dhe Vizatim
Titulli i lëndës:	Perspektiva e re në pikturë II
Niveli:	Bachelor-BA
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti -II- (Semestri: III - IV)
Numri i orëve në javë:	4
Vlera në kredi – ECTS:	4+4 (dy simestra 8 ECTS)
Koha / lokacioni:	E hënë, E martë 10:45-12:15 Fakulteti Arteve. Universiteti Prishtinës
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Majlinda Kelmendi
Detajet kontaktuese:	Email: majlinda.kelmendi@uni-pr.edu Tel: +37744-146-036
Përshkrimi i lëndës	Kursi "Perspektiva e re në pikturë II" ofron një eksplorim të thelluar të koncepteve dhe praktikave bashkëkohore në pikturë, duke i ndihmuar studentët të avancojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre teknike. Duke u fokusuar në analizën e veprave artistike dhe zhvillimin e projekteve individuale, ky kurs inkurajon një qasje kritike dhe eksperimentale ndaj procesit krijues. Studentët do të shqyrtojnë ndikimin e konteksteve kulturore dhe sociale në artin bashkëkohor, duke u angazhuar në praktika inovative që sfidojnë kufijtë e pikturës tradicionale. Nëpërmjet ushtrimeve të avancuara, diskutimeve dhe projekteve të thelluara, studentët do të krijojnë veprat e tyre duke integruar teorinë dhe praktikën në mënyrë të harmonishme.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet e Lëndës "Perspektiva e re në pikturë II" synon të ndihmojë studentin të thellojë kuptimin e tij mbi konceptet bashkëkohore dhe të avancuara të pikturës, duke inkurajuar një qasje kritike dhe reflektive ndaj praktikës artistike. Studentin do të ndihmojë të eksplorojë mënyra të reja për të interpretuar dhe zbatuar ide artistike, duke inkurajuar kreativitetin dhe inovacionin në krijimtarinë e tij. Ai do të mësojë të analizoje ndikimet kulturore dhe sociale që formojnë artin bashkëkohor dhe do të zhvillojë një stil personal, që sfidon praktikat tradicionale dhe standardet ekzistuese. Përmes projekteve individuale dhe diskutimeve kritike, studentin do të mësojë të përfshijë teori dhe praktikë në punën e tij, duke e përgatitur atë për sfidat e ardhshme në fushën e artit.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentin pritet të: 1. Krijojë punim artistike duke zbatuar koncepte dhe teknika të avancuara në pikturë, duke e reflektuar stilin e tij personal. 2. Analizojë dhe interpretojë veprat e artistëve bashkëkohorë, duke diskutuar ndikimin e konteksteve kulturore dhe sociale në art. 3. Demonstrojë aftësi kritike në reflektimin mbi procesin e krijimit, duke formuluar ide dhe koncepte që përmirësojnë punën e tij. 4. Pjesëmarrë në diskutime dhe prezantime që promovojnë shkëmbimin e ideve dhe praktikave artistike, duke forcuar njohuritë në artin bashkëkohor. 5. Zhvillojë një deklaratë artistike të qartë që përshkruan konceptin e tij artistik dhe qëllimet krijuese.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3 orë	30 Javë	90
Ushtrime teorike/laboratorike	1 orë	5 Javë	5
Punë praktike	2 orë	30 javë	60
Kontaktet me konsultimet			
Ushtrime në teren	1 orë	5 javë	5
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	2 orë	5 javë	10
Koha e studimit vetanak	1 orë	10 javë	10
Përgaditja përfundimtare	2 orë	5 javë	10
Koha e kaluar në vlerësim (2 orë	2 javë	4
Projektet,prezantimet ,etj	2 ore	3 javë	6
Totali	18	100	200 ore
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënjes në lëndën "Perspektiva e re në pikturë II" realizojmë qasje të kombinuar të ligjëratave teorike, analizës së rasteve dhe praktikave në klasë duke përvetësuar koncepte të avancuara në pikturë. Nëpërmjet demonstrimeve praktike dhe ushtrimeve eksperimentale, studenti zhvillon aftësitë për të krijuar dhe për të eksploruar materiale e teknika të reja. Diskutimet dhe prezantimet në grup përdoren për shkëmbimin e ideve dhe për të nxitur qasje kritike ndaj procesit krijues. Studenti prezanton punimet përmes analizës dhe reflektimit, duke zhvilluar aftësi të thelluar për të shprehur vizionin dhe konceptet e punimit artistik.		

<p>Metodat e vlerësimit: Sistemi i vlerësimit me pike</p>	<p>Vlerësimi për këtë kurs bazohet në një sistem pikësh që mat angazhimin, performancën dhe rezultatet e studentëve gjatë semestrit. Totali maksimal i pikëve është 100, të ndara si më poshtë:</p> <p>Komponentët e Vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesëmarrja aktive dhe vijimi i rregullt – 10 pikë <ul style="list-style-type: none"> ○ Vlerësohet përmes pranishmërisë së rregullt në orë dhe angazhimit aktiv në diskutime. 2. Provimi i semestrit I – 25 pikë <ul style="list-style-type: none"> ○ Përfshin temat e trajtuara gjatë semestrit të parë dhe projektet praktike dhe me shkrim të zhvilluara. 3. Provimi i semestrit II – 25 pikë <ul style="list-style-type: none"> ○ Përfshin temat e trajtuara gjatë semestrit të dytë dhe projektet praktike të zhvilluara. 4. Provimi përfundimtar – 40 pikë <ul style="list-style-type: none"> ○ Prezantimi i një projekti përmbledhës. Ky projekt vlerëson njohuritë dhe kreativitetin e studentit dhe projektet praktike të zhvilluara. <p>Sistemi i Notimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 91% – 100% e pikëve totale: Nota 10 (shkëlqyeshëm) • 81% – 90% e pikëve totale: Nota 9 (shumë mirë) • 71% – 80% e pikëve totale: Nota 8 (mirë) • 61% – 70% e pikëve totale: Nota 7 (mjaftueshëm) • 51% – 60% e pikëve totale: Nota 6 (kalues) • < 51% e pikëve totale: Nota 5 (nuk kalon)
<p>Literatura</p>	
<p>Literatura bazë:</p>	<p>Analize autorëve të ndryshëm. Kritika dhe vështirime estetike (material i përzgjedhur individualisht sipas kërkesave të studentit). Tommaso Trini, Nuovo alfabeto per il corpo, 1972. Achile Bonitto Oliva, Il territorio magico, 1971. Michael Kirby, Happening, 1968. Celant, Germano. Anselm Kiefer (1997) Charta ISBN 88 8158 130 2 Bradley, Fiona et al. Lisa Milroy (2001) Tate ISBN 1 85437 343 9 Fleck, Robert et al. Julian Schnabel (2004) Schirn</p>

	ISBN 3 7757 1386 7 Baerwaldt, Wayne. (2004) Daniel Richter – Pink Flag White Horse The Power Plant, U.S. ISBN 1894212053
Literatura shitesë:	Sol LeWitt, Douglas Huebler, Marcel Duchamp etj Godfrey, Tony. Painting Today Phaidon ISBN: 978-0-7148-4631-6 Nickas, Bob. Painting Abstraction: New Elements in Abstract Painting Phaidon Press ISBN-10: 0714849332 Allard, Sebastien et al. (2007) Royal Academy Illustrated 2007 Royal Academy of Arts ISBN 978 1 903973 23 3 Schwabsky, Barry. (2002) Vitamin P: New Perspectives in Painting Phaidon ISBN 0 7148 4246 X Collective. (2002) Dear Painter, paint me Centre Pompidou ISBN 9 782844261380 Mayer, Marc. (2006) Basquiat Merrell ISBN 978 1 8589 4361 9

Plani i dizajnuar i mësimit: Viti II (Simestri III)	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Roli dhe rëndësia konceptit të pikturës bashkëkohore dhe avancimi i qasjes personale.
Java e dytë:	Analizë e elementeve që formojnë një stil unik dhe ushtrime për eksplorimin e tyre.
Java e tretë:	Ushtrime për eksplorimin elementeve që formojnë një stil unik.
Java e katërt:	Ushtrime , punë praktike.
Java e pestë:	Pergatitja e esese dhe idese se percaktuar nga secili student. Konsulte dhe diskutim rreth ideve. Analize.
Java e gjashtë:	Studimi i efekteve të ndryshme për krijimin e emocioneve dhe mesazhit përmes ngjyrës dhe teksturës..
Java e shtatë:	Diskutim, pyetje rreth temave dhe ideve që do të trajtohen në lëndën: idesë së punimit artistik
Java e tetë:	Shqyrtim i veprave të artistëve të njohur bashkëkohorë dhe ndikimi i tyre në pikturën bashkëkohore.
Java e nëntë:	Eksperimentim për të thyer strukturat tradicionale dhe krijimi i një vizioni të ri në pikturë.

Java e dhjetë:	Zhvillimi i kompozimeve të lira dhe sfidimi i perspektivës tradicionale.
Java e njëmbëdhjetë:	Ushtrim, punë praktike Vazhdim i punës nga njësia e kaluar.
Java e dymbëdhjetë:	Punë praktike.Pergatitja per prezantim dhe perfundimi i detyres.
Java e trembëdhjetë:	Diskutim mbi marrëdhënien mes artit dhe mjedisit shoqëror, dhe mënyra se si përfshihet në pikturë.
Java e katërbëdhjetë:	Prezantimi me shkrim i punës simestrale
Java e pesëmbëdhjetë:	Vleresimi i detyrave të përfunduara, ese dhe punimi artistik.

Plani i dizajnuar i mësimit:	Viti II (Simestri IV)
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e gjashtëmbëdhjetë:	Studimi përmes imazhit dhe ndërtimi i një narrativë në veprat artistike.
Java e shtatëmbëdhjetë:	Eksperimentim për të kombinuar teknikat realiste me abstraksionin dhe për të krijuar një qasje unike.
Java e tetëmbëdhjetë:	Eksperimentim për të kombinuar teknikat për të krijuar një qasje unike.
Java e nëntëmbëdhjetë:	Përpilimi i ese rreth temës së e zgjedhur.
Java e njëzetë:	Prezantimi i kompozim-ides nga secili student.
Java e njëzetë e një:	Dialog në grup dhe analizë e punës së arritur
Java e njëzetë e dy:	Vazhdim i punës nga njësia e kaluar
Java e njëzet e tre:	Kombinimi i medimeve të ndryshme për të krijuar një efekt të ri në pikturë.
Java e njëzetë e katër:	Eksperimentim me medime të ndryshme për të krijuar një efekt të ri në pikturë..
Java e njëzetë e pesë:	Punë praktike.Vazhdim i punës nga njësia e kaluar..
Java e njëzet e gjashtë:	Diskutim dhe analizë e zhvillimit të projekteve individuale, me fokus në reflektimin kritik.
Java e njëzet e shtatë:	Përgatitja e një deklaratë artistike dhe përshkrimi i qasjes dhe qëllimeve artistike.
Java e njëzetë e tetë:	Prezantim i projekteve dhe diskutime për të përmirësuar dhe finalizuar veprat.
Java e njëzet e nëntë:	Shqyrtim i punimeve, duke përfshirë feedback për përmirësime të mëtejshme.
Java tridhjetë:	Finalizimi i projekteve dhe përgatitja për prezantimin të veprave përfundimtare dhe vlerësimi

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Arrdhja 15 minuta për përgatitje para orarit të përcaktuar të mësimit.</p> <p>Fikja e telefonave celularë</p> <p>Zbatimi me korrektesi i orarit të mbarimit të mesimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për kredi të plotë, duhet të ruani të gjithë punën tuaj deri në fund të semestrit. • Të gjitha projektet duhet të etiketohen me emrin tuaj, datën e përfunduar dhe titullin e detyrës.

Përgatitur: Prof. Majlinda Kelmendi

Prishtinë, 20.07.2024